



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency

Data: 12.04.2019

Ref.: 589/190

Bazuar në nenin 7, dhe 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Ligji për qasje në dokumente publike (Ligji Nr. 03/ L-215, datë 7 tetor 2010), Rregulloren mbi punën e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, Nr. 621/18D, datë 12.06.2018, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 66-të, të mbajtur më 27 mars 2019, mori:

V E N D I M

Refuzohet kërkesa Nr.873/18, datë 06.08.2018 e parashtruar nga Leonis Gashi, Sekretar i përgjithshëm në Kolegjin ISPE, për qasje në dokumente publike, përkatësisht në Procesverbalin e Mbledhjes së 58-të të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KSHC) mbajtur me 25.07.2018.

Arsyetimi

Këshilli Shtetëror të Cilësisë (KSHC) i Agjencisë së Kosovës për Akreditim në mbledhjen e mbajtur me 10 Prill 2019, ka trajtuar kërkesën e Leonis Gashi, Sekretar i Përgjithshëm në Kolegjin ISPE.

Bazuar në nenin 12, paragrafi 1.3, dhe neni 13, paragrafi 1.2 të Ligji për qasje në dokumente publike (Ligji Nr. 03/ L-215, datë 7 tetor 2010), KSHC ka vendosur ta refuzoj kërkesën e tillë, pasi që i njëjti dokument i kërkuar nga z.Gashi, pra Procesverbalin i Mbledhjes së 58-të të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KSHC) mbajtur me 25.07.2018, është një nga provat e një procesi hetimor të cilin është duke u hetuar nga Policia e Kosovës.

Duke mos dashur te interferojmë në një procedurë hetimore, me bërjen publike te një dokumenti zyrtar i cili është pjesë e kësaj procedure, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtojë kërkesën për rishqyrtim e çështjes duke kërkuar nga institucioni që të rishqyrtojë vendimin. Kërkesa për rishqyrtim mund të bëhet sipas nenit 7, paragrafi 9 i Ligjit për qasje në dokumente publike (Ligji Nr. 03/ L-215, datë 7 tetor 2010), në afatin prej 15 ditësh pas marrjes së përgjigjes.

Vendimi u dërgohet:

- Z. Leonis Gashi, Sekretar i përgjithshëm në Kolegjin ISPE
- Arkivit të AKA-së.

  
Prof. Dr. Gazmend Luboteni  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

